

# AUDITUES ENERGJITIK NË NDËRTESEA

## Rreth nesh

Audituesi i energjisë vlerëson dhe analizon se si energjia po përdoret në një objekt rezidencial, tregtar ose institucional duke identifikuar mundësitë e ruajtjes së energjisë si edhe duke bërë rekomandime se ku mund të reduktohet ose optimizohet konsumi.

Ekzistojnë tre lloje kryesore të auditimeve të energjisë: Auditimet e nivelit 1 (anketat e përgjithshme që ju lejojnë të identifikoni me shpejtësi mundësitë për kursimin e energjisë); Auditimet e nivelit 2 (analizat e vrojtimit të energjisë që përdoren zakonisht në ndërtesat tregtare); dhe Auditimet e Nivelit 3 (analiza të detajuara të modifikimeve me kapital intensiv).

Programi 12 javor i Audituesit të Certifikuar të Energjisë në ndërtesa u ofron pjesëmarrësve njohuritë themelore të nevojshme për të vlerësuar se si përdoret energjia në një objekt dhe për të identifikuar se ku mund të reduktohet konsumi. Për më tepër, ai mbulon metodologjitë e dobishme të llogaritjes përmes shembujve praktikë dhe skenarëve të mundshëm kompjuterik.

Ky është kursi i duhur për ju nëse jeni ose do të përfshiheni në auditimet e ndërtesave rezidenciale dhe tregtare dhe ju nevojitet të zgjeroni njohuritë tuaja për procesin e plotë të analizës energjitike dhe të raportimit.



Save the  
PLANET

## OBJEKTIVAT KRYESORE

- Të kuptuarit të objektivave të auditeve energjitike dhe protokollet e tyre
- Analizimi i niveleve të ndryshme të auditit dhe planifikimi i suksesshëm i auditit
- Raportimi efektiv i rezultateve të auditit energjistik.
- Të kuptuarit të formave të energjisë, ndërlidhjes së njësive, strukturat e raporteve dhe vlerësimi i tyre.
- Analizimi i konsumit energjistik në ndërtesa dhe përcaktimi i balancave energjitike.
- Si të përcaktohet informacioni i nevojshëm përpara dhe gjatë vizitave në terren dhe si të analizohen të dhënat e grumbulluara
- Aftësimi në përdorimin e metodologjive dhe programeve kompjuterike për analizë dhe për vendimmarrje në investime të projekteve pavarësisht natyrës së tyre; fokusi kryesor mbeten projektet në efikasitetin e energjisë.
- Të kuptuarit të koncepteve dhe karakteristikave të sistemeve energjitike.
- Rritja e standartit profesional të specialistëve në fushën e efikasitetit të energjisë.



## MODULET: AUDITUES ENERGETIK NË NDËRTESA

## GRUPET E INTERESIT

- Inxhinierët energjistik dhe konsulentë
- Auditues të rinj të energjisë
- Menaxherë të energjisë
- Profesionistë të kompanive të shërbimeve energjitike (ESCO)
- Profesionistë të çertifikimit të performancës energjitike (EPC)
- Organizata në zhvillimin e projekteve energjitike

- Legjislacioni mbi Efikasitetin e Energjisë
- Burimet kryesore të energjisë
- Bazat e auditimit të energjisë mbështetur në protokollin ndërkombëtar IPMVP
- Teknologjitë dhe impiantet termike.
- Sistemet HVAC dhe performanca energjetike në sistemet elektrike
- Performanca energjitike në ndërtesa
- Konceptet bazë të analizës së një projekti të energjive të pastra
- Laborator/ Praktikë Profesionale & programe kompjuterike
- Analizë & vlerësim teknik-ekonomik i investimit për kursimin e energjisë